



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 440/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Ymer Hoxha dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesë nga Fadil Matarova paraqitur kundër antareve të Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ) në Prishtinë për shkak të moslejimit të votimit të personit në fjale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.11.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Fadil Mataroves nga Prishtina.

**Arsyetim**

PZAP-i, më datë 03.11.2013 ka pranuar një ankesë nga Fadil Matarova, në të cilën theksohet se me datën 03 nëntor 2013, qytetari në fjale me rastin shrytezimit të drejtes së tij për të votuar iu është ndaluar votimi i tij në qendrën e votimit duke mos e specifikuar vendvotimin e tij në Prishtinë për shkak të prezencës së sprej-verifikimit në gishtat e tij, duke konstatuar se personi në fjale e ka shfrytëzuar të drejtën e tij për të votuar. Fadil Matarova deklaroi se ka shenja të sprej-verifikimit në dorë por nuk din ke ta fajesoje.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar**

PZAP-i konstatoi se nga dëshmitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe nga pretendimet e ankuesit në ankesën e tij se iu është shkele e drejta për të votuar, PZAP-i i vlerëson si pabazuar dhe të pa argumentuar në prova dhe dëshmi bindëse, siç pretendon pala ankuese në ankesën e saj, andaj ankesa e tillë është e pabazuar dhe se për këtë çështje PZAP-i në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe dhe nenit 3.6.pika c. vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 440/2013 më datën 06.11.2013

**Kryesuesi i Panelit**  
**Xhevdet Abazi**



***Këshillë Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*